

Qëllimi i këtij projekti është që të rinj, në fillim të karrierës së tyre profesionale, të fitojnë një eksperiencë pune në Bashkinë Tiranë, duke u ofruar mundësinë për të zhvilluar aftësitë e tyre analitike dhe kërkimore përmes **konkurimit me një koncept – ide për projekt** ose **me një koncept – ide për studim**, në një nga fushat e veprimtarisë së Bashkisë Tiranë. Të rinjve u ofrohet mundësia të përgatisin dhe dorëzojnë një propozim të plotë teknik dhe financiar të projektit si dhe të përfundojnë studimin gjatë internshipit, duke bashkëpunuar nga afër me stafin e Bashkisë për një periudhë 3 muajore praktike pune. Projekti/studimi duhet të konceptohet për t'u zbatuar brenda territorit të Bashkisë Tiranë.

Në përfundim të internshipit, të rinjtë do të përfitojnë:

- Praktikë pune 3 muajore në Bashkinë Tiranë
- Aftësi në hartim dhe zhvillim projekti, kërkim shkencor, analiza e të dhënave, të folurit në publik, prezantim, komunikim efektiv, punë në grup
- Trajnim mbi “Metoda të Kërkimit Shkencor”
- Trajnim mbi “Planifikim dhe Menaxhim Projekti”
- Një rrjet kontaktesh me profesionistë të fushës;
- **Një çmim për punimin e dorëzuar, me vlerë 91.000 Lekë bruto/ personi.**
- Certifikatë pjesmarrjeje.

Fushat për propozimin e një koncept ideje për projekt ose për studim janë:

- Infrastruktura dhe Teknologjia
- Energjia, Uji dhe Mbetjet Urbane
- Mobiliteti
- Qytetarët dhe Stili i Jetesës
- Smart City
- Mjedisi
- Qeverisja dhe Edukimi
- Zhvillimi Ekonomik Vendor
- Zhvillimi Urban
- Qeverisja Vendore